U D H Ë Z I M
Nr.1, datë 11.2.2002

PËR AKSIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 11 dhe 13 të ligjit nr.8437, datë 28.12.1998 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", Ministria e Financave nxjerr këtë,

U D H Ë Z I M:

Prodhuesit dhe importuesit e mallrave të tatueshme me akcizë janë personat fizikë a juridikë vendas dhe të huaj, që i nënshtrohen këtij tatimi mbi një numër të kufizuar mallrash për konsum masiv të brendshëm.

Në zbatim të nenit 3 pika "B" të ligjit për artikujt verë dhe konjak, uzo, votka, fërnet, ponç, likerna, wiski, campari, rum, martini dhe pije të tjera alkoolike" me fjalën "vlerë" do të kuptohet:

- për prodhimin e vendit, çmimi para tatimit;
- për importin, vlera doganore (përcaktuar mbi bazën e ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

Në importet e artikujve"konjak, uzo, votka, fërnet, ponç, likerna, wiski, campari, rum, martini dhe pije të tjera alkoolike", subjektet importuese kanë deklaruar vlerën e tyre doganore në 400 lekë për litër dhe kanë blerë pulla akcize (në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve) me vlerë 40 lekë për litër, ndërsa në momentin e zhdoganimit vlera doganore e llogaritur e këtyre mallrave rezulton më e lartë se 400 lekë për litër, në këtë rast, degët e doganave nuk do të kryejnë zhdoganimin e tyre deri në momentin e e pagesës së diferencës së akcizës (nga 40 në 350 lekë për litër) nga subjekti. Kjo pagesë në Bankën e Kursimeve do të konfirmohet nga dega e tatimeve ku është kaluar dhe pagesa e parë (sipas kapitullit IV, pika 1).

Edhe për artikullin "verë" do të veprohet si më sipër. Për alkoolin e importit, subjekti do të deklarojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve sasinë e alkoolit që do të importojë dhe njëkohësisht të paraqesë dokumentin e pagesës së akcizës të alkoolit (50 lekë për litër). Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk do të kryejë zhgodanimin e alkoolit të importuar nga subjekti pa konfirmimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për pagesën e akcizës.

Në zbatim të nenit 3/1 të ligjit, organet tatimore në rrethe do të regjistrojnë të gjithë importuesit, prodhuesit dhe tregtarët me shumicë të mallrave me akcizë. Për këtë qëllim, ato kërkojnë që çdo tatimpagues, i cili importon, prodhon apo tregton me shumicë mallra akcize, të regjistrohen për akcizën. Për këtë qëllim, tatimpaguesit ekzistues janë të detyruar që të plotësojnë dhe të paraqesin brenda datës 31 janar të çdo viti formularin përkatës, forma dhe përmbajtja e të cilit është bashkëngjitur këtij udhëzimi. Me plotësimin e këtij formulari dhe paraqitjen e tij në degën e tatimeve në rreth, tatimpaguesi quhet i regjistruar për akcizën. Tatimpaguesit që regjistrohen të rinj gjatë periudhës në vazhdim, në qoftë se do të kryejnë aktivitet në fushën e importimit, prodhimit apo tregëtimit me shumicë të mallrave të ekcizueshme, janë të detyruar gjithashtu që brenda 30 ditësh nga fillimi i aktivitetit të plotësojnë dhe të paraqesin formularin përkatës. Një kopje e çdo formulari, dërgohet nga dega e tatimeve në rreth në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit dhe e paraqitjes së tij nga tatimpaguesi.

Mosregjistrimi në organet tatimore i tatimpaguesve, aktiviteti i të cilëve ka të bëjë me importimin, prodhimin, ruajtjen apo tregtimin me shumicë të mallrave që tatohen me akcizë, në zbatim të nenit 10 të ligjit, është shkelje dhe përveç pagimit të shumës së skcizës që duhet paguar dënohet edhe me konfiskimin e mallrave të tatueshme me akcizë.

Në zbatim të paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 4 të ligjit, tatimpaguesit prodhues të birrës janë të detyruar të deklarojnë dhe të paguajnë akcizë për të gjithë sasinë e birrës të prodhuar në fakt. Organet tatimore kontrollojnë në vazhdimësi vërtetësinë e deklarimit të sasisë së birrës së prodhuar. Për këtë, ato marrin parasysh konsumin e maltos si lëndë e parë për prodhimin e birrës sipas kushtit teknik në bazë të të cilit me çdo kilogram malto të konsumuar prodhohen 5 litra birrë. Në rastin kur,

nga kontrolli tatimor rezulton se sasia e birrës së prodhuar për çdo kilogram malto të konsumuar është më e vogël se 5 litra, organet tatimore korigjojnë në rritje sasinë e deklaruar të birrës.

Të gjithë tatimpaguesit, tregtues me shumicë të maltos janë të detyruar të shesin malto vetëm për tatimpagues të regjistruar si prodhues birre duke shënuar në faturën e shitjes së maltos të dhëna të hollësishme për blerësin prodhues birre, si emrin dhe mbiemrin e tij, numrin e pasaportës, emrin tregtar të tatimpaguesit blerës, NIPT-in dhe kodin fiskal të tij, adresën, etj. Ato nuk lejohen të shesin malto për individë që nuk janë të regjistruar në organet tatimore si prodhues birre (pasi malto nuk konsumohet nga individët apo nga tatimpagues të tjerë) apo për persona që nuk japin apo nuk kanë të dhënat identifikuese të përcaktuara si më sipër. Tatimpaguesit, tregtues me shumicë të maltos, të cilët nuk veprojnë si më sipër, detyrohen të paguajnë 294 lekë akcizë për çdo kilogram malto të shitur për persona të paregjistruar si prodhues birre apo për persona që nuk japin të dhënat e kërkuara identifikuese.

Në zbatim të nenit 4, paragrafi i fundit i ligjit, për mallrat e importuara përmendur në nenin 3 të ligjit, akciza e të cilave është në përqindje, llogaritja e akcizës bëhet në bazë të vlerës doganore plus taksën doganore.

Në zbatim të gErmës "a" të nenit 5 të ligjit, për mallrat e prodhuara në vend që tatohen me akcizë dhe akciza e të cilave nuk paguhet nëpërmjet blerjes së pullës fiskale, akciza llogaritet në çastin e lëvizjes së mallrave nga vendi i prodhimit. Kjo do të thotë se akciza llogaritet në momentin që malli del jashtë vendit të prodhimit, pavarësisht nga fakti nëse ai shkon për shitje apo, për zhvendosje jashtë vendit të prodhimit si në magazinë, dyqan etj., pa kaluar në shitje. Akciza e llogaritur si më sipër deklarohet dhe paguhet për periudhën 1 deri më 15 të muajit brenda datës 20 të po atij muaji, ndërsa për periudhën 16 deri me 31 të muajit, brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Për artikujt e duhanit dhe pijeve alkoolike të destinuara për eksport ndalohet aplikimi i pullave fiskale dhe asnjë rimbursim nuk jepet në të tilla raste.

Në zbatim të nenit 7 të ligjit, akciza paguhet edhe për mallra të akcizueshme të prodhuara në vend me lëndë të para të importuara dhe të akcizueshme në import. Kjo do të thotë se akcizës i nënshtrohen edhe prodhime të tilla si pijet alkolike të të gjitha llojeve, të prodhuara në vend me alkool industrial të importuar, për të cilën është paguar akcizë në momentin e importimit.

Pullat fiskale të artikujve të duhanit dhe të pijeve alkoolike janë letra me vlerë të ruajtjes së rreptë dhe monopol i shtetit, dhe për ruajtjen e administrimin e tyre zbatohen dispozitat ligjore në fuqi, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.309, datë 15.7.1987 "Për përgatitjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e dokumenteve që i nënshtrohen kontrollit të rreptë".

Personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtarinë e prodhimit, importimit, magazinimit apo hedhin në qarkullim në Republikën e Shqipërisë artikuj të duhanit e të pijeve alkoolike janë të detyruar të vendosin pullën fiskale të Ministrisë së Financave nën letrën e tejdukshme të çdo pakete cigareje dhe mbi kapak të çdo shisheje me pije alkoolike apo ambalazhim tjetër të pijeve alkoolike.

Artikujt e duhanit dhe pijeve alkoolike, në të cilat do të vendosen pullat fiskale të Ministrisë së Financave, janë sipas listës bashkëngjitur këtij udhëzimi.

I. Për prodhimin e pullave fiskale

1- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përcakon nevojat vjetore për pulla fiskale të ndara sipas kategorive të cigareve, puros dhe pijeve alkoolike, sipas llojit dhe litrazhit përkatës dhe, në zbatim të dipozitave ligjore në fuqi, lidh kontratën me Bankën e Shqipërisë për prodhimin e pullave fiskale.

2 - Emetimi i pullave fiskale bëhet nga Ministria e Financave sipas konfigurimit dhe ngjyrës së miratuar më parë prej saj. Për këtë, kontrata midis dy institucioneve shoqërohet me aneksin përkatës ku, përveç konfigurimit dhe ngjyrës së miratuar, jepen edhe elementët e sigurisë së letrës. Këto elemente dhe mënyrat e kontrollit të tyre, Drejtori e Përgjithshme e Tatimeve ia bën të njohura me shkrim në një material sekret degëve të tatimeve e doganave në rrethe.

3 - Pullat prodhohen nga Banka e Shqipërisë dhe ruhen e shpërndahen në ambientet e saj sipas procedurës së përcaktuar në kapitullin III pika 4 e këtij udhëzimi.

II.Kontrolli i elementëve të sigurisë të pullave

1- Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e të sigurojnë menjëherë pajisjet e nevojshme (dedektore ultraviolete) për kontrollin e elementeve sekret të sigurisë së pullave.

2 - Urdhërohen Policia Tatimore e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Departamenti

Operativ Hetimor i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të zbatojnë dispozitat ligjore në fuqi për konfiskimin e të gjitha artikujve të duhanit dhe pijeve alkoolike të papullosura që importohen, prodhohen, tregtohen dhe qarkullojnë pa pullë. Çdo inspektor në Policinë Tatimore dhe Departamentin Operativ Hetimor të instruktohet me hollësi rreth elementëve të sigurisë të pullës dhe mënyrës së kontrollit të tyre.

III. Furnizimi i pullave

1. Kërkesa për blerje pullash nga subjekti paraqitet dhe depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, shoqëruar me këtë dokumentacion:

- Vendimin e regjistrimit në gjykatë të subjektit;
- vertifikatën e regjistrimit në organin tatimor të rrethit ku ushtron veprimtarinë prodhuese a tregtare si dhe NIPT-in përkatës të regjistrimit në TVSH;
- vërtetimin nga Dega e Tatimeve për pagesën e detyrimeve tatimore ndaj shtetit deri në datën e paraqitjes së kërkesës, si dhe një herë në tre muaj vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për shlyerjen e detyrimeve në doganë;
- kontratën (të noterizuar) me firmën prodhuese ose tregtare të cigareve apo pijve alkoolike.

2. Për dokumentet e mësipërme, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve hapet dosje e veçantë për çdo subjekt me numër rendor dhe të protokolluar konform rregullave.

3. Subjekti që kërkon të blejë pulla fiskale do të paraqitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ku do të dorëzojë një kërkesë me shkrim lidhur me nevojat mujore dhe vjetore për pulla. Për çdo tërheqje të veçantë subjekti do të njoftojë me shkrim të paktën 3 ditë përpara.

4. Punonjësi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i ngarkuar me mbajtjen e dosjeve dhe regjistrave përkatës si dhe magazinieri, shoqëruar me dy policë tatimor, pasi kanë njoftuar më parë sektorin përkatës në Bankën e Shqipërisë furnizohen me sasinë e pullave të kërkuara nga subjekti. Pullat tërhiqen brenda ditës së furnizimit nga presidenti i firmës ose personi i autorizuar prej tij me prokurë. Për furnizimin pasardhës me pulla fiskale, subjekti të deklarojë për gjendjen e pullave të furnizimit paraardhës.

Me tërheqjen e pullave përpilohen dokumentet e mëposhtme:

- Fletë dalje nga Banka e Shqipërisë për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me çmimin e vendosur në kontratë.
- Mandatarkëtimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe mandatpagese për subjektin, me çmimin e miratuar nga Ministri i Financave.

IV. Pagesa e akcizës

1.Pagesa e akcizës bëhet vetëm pranë Bankës së Kursimeve të Shqipërisë dhe një kopje e urdhërxhirimit a mandatarkëtimit përkatës, depozitohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të paktën 3 ditë përpara. Kopjet e urdhërxhirimit ose amdnat arkëtimit duhet të kenë shënimin e mëposhtëm nga Dega përkatëse e Tatimeve: "Vërtetojmë kryerjen e pagesës". Ky shënim pasohet nga firma e Kryetarit të Degës së Tatimeve dhe vula e Degës së Tatimeve. Me tërheqjen e ekstratit bankar, Dega e Tatimeve bën brenda ditës kontabilizimin përkatës në llogarinë e akcizës.

2. Në nenin 3 të ligjit nr.8437, datë 28.12.1998 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", shkronja a, për cigaret e kategorisë së parë, të dytë e të tretë, vlera e akcizës është për paketë (me 20 cigare paketa, sipas standartit shtetëror STASH 1456-88). Pra vlera e akcizës e parapaguar është përcaktuar për një paketë që përmban 20 cigare. Për paketat që përmbajnë më tepër se 20 cigare bëhen llogaritjet përkatëse për pagesën e akcizës. Kështu p.sh. për paketat e kategorisë së dytë të importit me 25 cigare vlera e akcizës për një pullë rezulton 13.75 lekë (25 cigare x 11 lekë : 20 cigare). Kështu do të veprohet për çdo lloj pakete e cila ka më shumë ose më pak se 20 cigare.

V. Marrëdhëniet me Doganën

1.Për çdo tërheqje të pullave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe i komunikon emrin tregtar të shoqërisë, sasinë dhe llojin e pullave të blera, shumën e akcizës së paguar për to, datën dhe numrin përkatës të çertifikatës tatimore dhe NIPT-it. Nga ana e saj, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave brenda ditës së marrjes së shkresës për blerjen e pullave nga subjekti, njofton degët e saj në rrethe, të cilat regjistrojnë në regjistra të veçantë të dhënat e deklaratës së eksportit të pullave e më tej të mallit të pullosur.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për subjektin që importon cigare, puro dhe pije alkoolike me pullë fiskale do të bëjë verifikimin me të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, që lloji e sasia e mallit të importuar përputhet me llojin e sasinë e mallit për të cilin subjekti

ka paguar akcizë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përpara se të llogarisë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar do të saktësojë shumën e akcizës së paguar me blerjen e pullës, për ta vendosur në deklaratën doganore, siç është vepruar deri më sot.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave çdo muaj të dërgojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve sasitë e zhdoganuara sipas llojeve të cigarave dhe të pijeve alkoolike, datën e zhdoganimit, për kryerjen e rakordimeve me sasitë e pullave të tëthequra për import nga subjektet.

V. Rakordimi me subjektet.

1.Në fund të vitit kalendarik,. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet organeve të saj tatmore bën bilancin nëpërmjet rakordimit me subjektet lidhur me përdorimin e pullave, shlyerjen e detyrimeve të tjera fiskale si dhe inventarin e pullave (gjendje në Shqipëri apo tek prodhuesi) dhe mallit të pullosur gjendje. Për cigaret, në fund të vitit kalendarik, mbas plotësimit të saktë të të dhënave të mësipërme, nëpërmjet akt rakordimit të paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, subjekteve do t'i jepet 0.5 për qind e pullave të tërhequra, si pullë fiskale e dëmtuar dhe hedhurinë.

2.Të gjithë subjektet importues të artikujve të duhanit dhe të pijeve alkoolike për sasinë e pullave që do të eksportojnë të kenë deklaratën doganore të eksportit të pullave. Me kryerjen e rakordimit ndërmjet tyre dhe degëve të tatimeve në çdo tremujor, subjektet të deklarojnë sasinë e pullave tek importuesi dhe adresën e plotë të firmës prodhuese, si dhe të paraqesin një kopje të deklaratës doganore të eksportit të pullave.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve çdo muaj të përpunojë në mënyrë të kompjuterizuar të dhënat dhe të nxjerrë evidencë mujore për sasinë e pullave të blera, sujektet përkatëse dhe akcizën e paguar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Anastas Angjeli

Artikujt e duhanit dhe pijeve alkoolike në të cilat do të vendoset pullë fiskale

I.Duhani
1. Cigare
2. Puro
3. Duhan kaush

II. Pijet alkoolike
1. Verë dhe shampanjë
2. Raki
3. Vodka
4. Konjak
5. Uzo
6. Fërnet
7. Ponç
8. Wiski
9. Xhin
10. Rum
11. Martini
12. Campari
13. Të gjithë llojet e likernave
14. Të tjera pije alkoolike të pashënuara sipër.

V.O. Mbyllet me numrin 14 (katërmbëdhjetë).

Dega e Tatimeve dhe Taksave të Rrethit _____

1. Emri i firmës_____

2. Adresa

a) Salia_____

b) Vendi/vendet, ku ushtrohet veprimtaria ekonomike _____

3.Pronari, përfaqësuesi ligjor i prokuruar ose personi kontaktit i prokuruar (emër, mbiemër) _____

4. Numri i telefonit _____

5. Numri i NIPT-it_____

6. Numri i certifikatës tatimore _____

7. Lloji i aktivitetit

A - Importuesi i:

- duhan-cigareve
- karburanteve
- pijeve alkoolike
-etj.

B - Prodhuesi i:

-Duhan-cigareve
-Karburanteve
-Pijeve alkoolike
-etj.

C - Tregtues me shumicë të:

- duhan-cigareve
- karburanteve
- pijeve alkoolike
- etj.

8.Numri përkatës rendor i regjistrit në Degën e Tatimeve

9.Tatimpagues i trajtimit në:

a - sektorin e 200 të mëdhenjve,
b - biznesin e madh
c - biznesin e vogël.

Pronari
Emër, Mbiemër

Vërtetohet
Kryetari i Degës

Firma